

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 9 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4241/1 datë 1.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4429/1 datë 17.10.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4638/2 datë 03.11.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 16-të mbajtur më 3.11.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim
për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive-operator i rrjetit kabllor VIVA NET SHPKNJP Berovë, për shkak se nuk ka dërguar në vazhdim sinjal me përmbajtje të njëjtë me atë që u ofrohet abonentëve të saj deri në lokacionin për mbledhjen e sinjaleve të vendosur në secilën prej zonave në nivel rajonal, për distribuim të mëtejshëm deri në sistemin për mbikëqyrje programore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në Shkup, që është në kundërshtim me nenin 144 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV).

Shkelja nga paragrafi (1) të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4429/1 datë 17.10.2025., që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që Shoqëria Tregtare Radiodifuzive-operator i rrjetit kabllor VIVA NET SHPKNJP Berovë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV, përkatësisht në vazhdimësi të dërgon sinjalin dalës (me përmbajtje të njëjtë me atë që i ofrohet abonuesve) deri në lokacionin përkatës për mbledhjen e sinjalit.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi ka vepruar sipas aktvendimit për ndërmarrjen e masës-paralajmërim publik.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi nuk vepron sipas aktvendimit përkatësisht vazhdon të kryejë shkelje për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LShMAAV, do të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në përputhje me nenin 6 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të LShMAAV, ndërmerr masa në përputhje me ligjin në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të LShMAAV ose dispozitave të miratuara në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 të LShMAAV, Agjencia është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të ligjit, lejeve, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave ligjore dhe në përputhje me nenin 27 dhe nenin 28 të LShMAAV, Agjencia me datë 17.10.2025., ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore në lidhje me përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në nenin 144 paragrafi (3) të LShMAAV, sipas të cilit operatorët që ritransmetojnë shërbime programore janë të detyruar sinjalin e tyre dalës me të njëjtën përmbajtje me atë që i ofrohet abonentëve, në vazhdim ta dërgojnë deri në lokacionin për mbledhjen e sinjaleve

të vendosur në secilën prej zonave në nivel rajonal në përputhje me nenin 62 paragrafi (4) të LShMAAV, për distribuim të mëtejshëm deri në sistemin për mbikëqyrje programore të Agjencisë në Shkup. Gjatë mbikëqyrjes së kryer Agjencia konstatoi se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive-operator i rrjetit kabllor VIVA NET SHPKNJP Berovë, që sipas notifikacionit nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të ushtron veprimtari në territorin e komunës së Berovës dhe komunës së Pehçevës, nuk ka dërguar në vazhdimësi sinjalin me përmbajtje të njëjtë me atë që i ofrohet abonentëve të tij, deri në lokacionin për mbledhjen e sinjalit të vendosur në secilën prej zonave në nivel rajonal, për distribuim të mëtejshëm deri në sistemin për mbikëqyrje programore të Agjencisë në Shkup, që është në kundërshtim me nenin 144 paragrafi (3) të LShMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë specifikuar në detaje në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-4429/1 datë 17.10.2025., që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LShMAAV dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë, pika 9 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4429/1 datë 17.10.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4638/2 datë 03.11.2025., për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LShMAAV cekur në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim me të cilin ndaj subjektit në fjalë të ndërmerret masë paralajmërim publik dhe urdhërohet që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV, në mënyrë që në vazhdim të dërgon sinjalin dalës (me të njëjtën përmbajtje me atë që i ofrohet abonentëve) deri në lokacionin përkatës për mbledhjen e sinjalit.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhërit, përkatësisht sipas paralajmërimit publik dhe në vazhdim e dërgon sinjalin dalës (me përmbajtje të njëjtë me atë që i ofrohet abonentëve të tij) deri në lokacionin përkatës për mbledhjen e sinjalit.

Në përputhje me nenin 24 të LShMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të ngrejë padi për inicim të kontesti administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicimin e kontesti administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-4429/1 datë 17.10.2025.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontesti administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontesti administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.